



6

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

KOMISIONI I BUXHETIT, FINANCËS DHE TAKSAVE-TARIFAVE

Datë 11.06.2026

RAPORT VENDIMMARRJEJE

Projekt-vendimin (*titulli i projektvendimit*): **PËR MIRATIMIN E NGRITJES DHE FUNKSIONIMIT TË “QENDRËS PËR SHËRBIME MBËSHTETËSE PËR FËMIJËN DHE FAMILJEN” ME MBËSHTETJEN NGA PROGRAMI I FONDIT SOCIAL TË BUXHETIT TË SHTETIT PËR VITET 2026-2028 DHE BUXHETI I BASHKISË DURRËS**

Baza ligjore:

Në zbatim të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, Deklaratën e Përgjithshme të Drejtave të Njeriut dhe Konventën e Drejtave të Fëmijëve, Ligjit nr. 121/2016, “Për Shërbimet e Përkujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, Ligjit nr. 68/2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Ligjit nr. 18/2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve”, VKM-së nr. 658, datë 17.10.2005 “Për Standartet e Shërbimeve Shoqërore”, Udhëzimin nr. 911, datë 27.12.2018 “Për miratimin e Standarteve të Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror në Qendrat Komunitare Shumëdisiplinore”, Planit Social Vendor 2025–2028 të Bashkisë Durrës, Marrëveshjen e bashkëpunimit Nr.2420 prot, datë 18.02.2026 të lidhur ndërmjet Bashkisë Durrës dhe Shërbimit Social Shtetëror për zbatimin e projektit: “Qendër për Shërbime Mbështetëse për Fëmijën dhe Familjen”, mbështetur financiarisht nga programi i Fondit Social.

Propozimi nga kryetari/këshilltarët/tjetër (*Çfarë propozohet në projektvendim*):

Kryetari i bashkisë, sipas relacionit të hartuar nga Drejtoria e Shërbimeve Sociale Drejtoria e Buxhetit dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore, i propozon Këshillit Bashkiak të shqyrtojë konform akteve ligjore dhe të vendosë:

1. Ngritjen dhe Funksonimin e Qendrës për “Shërbime Mbështetëse për Fëmijën dhe Familjen” me një strukturë prej 5 punonjësish.
2. Fondin e shpenzimeve të personelit dhe shpenzimeve operative për Qendrën për “Shërbime Mbështetëse për Fëmijën dhe Familjen” për vitin 2026 është 5,241,680 lekë e financuar nga Fondi Social, alokuar nga Buxheti i Shtetit, i ndarë si më poshtë vijon:
 - Për paga (llogaria ekonomike 600) **4,308,128** lekë.

- Për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore (llogaria ekonomike 601) **708,384 lekë.**
 - Për shpenzime operative (llogaria ekonomike 602) **225,168 lekë.**
3. Niveli i pagave të këtyre punonjësve është sipas lidhjes nr. 5, të Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.17, datë 02.04.2026 “Për miratimin e nivelit të pagave për punonjësit e institucioneve në varësi të Bashkisë”.
 4. Veprimet financiare të kësaj qendre do të kryhen nga nëpunësi zbatues i nivelit të dytë pranë Qendrës Ditore të të Moshuarve.
 5. Ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve Sociale, Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Drejtoria Ekonomike, Drejtoria e Buxhetit, Qendra Ditore e të Moshuarve, Qendra për Shërbime Mbështetëse për Fëmijën dhe Familjen (SHMFF) .

Analiza Financiare/ Buxheti total/natyra e financimit (të ardhurat e veta, transferta etj):

Fondi Social, alokuar nga Buxheti i Shtetit.

Drejtorja/Spektori përgjegjës që ka përgatitur materialin:

Drejtorja e Shërbimeve Social, Drejtoria e Buxhetit dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore.

Impakti social/grupet që preken:

Banorët e Bashkisë Durrës.

A është objekt konsultimi: (PO/JO)

JO.

Komisioni i përhershëm/përkohshëm i Buxhetit, Financës dhe Taksave-Tarifave, u mbledhë më datë 11.06.2026, dhe shqyrtoi pikën nr. 6 të rendit të ditës, relacionin dhe dokumentat shoqërues të tij.

Komunikimi midis administratës dhe komisionit i përhershëm/përkohshëm:

Mbledhja dhe kjo pikë e rendit të ditës nr 6 u hap për diskutim.

Pas diskutimit specifik nga përfundimit të bashkisë të gjatë atëherë prezant u diskutuan me kaluar në parim.

Për sa më sipër, pas shqyrtimit, të projekt vendimit dhe materialeve shoqëruese, Komisioni me shumicë votash, vendosi:

T'i propozojnë Këshillit Bashkiak:

- a- Kalimin e projektaktit në mbledhjen e Këshillit për vlerësimin e mëtejshëm dhe për shqyrtim
- b- Miratimin e projekt aktit
- c- Refuzimin e miratimit të projektaktit
- d- Miratimin e projektaktit me ndryshimet si vijon:
- e- _____

Komisioni i Buxhetit, Financës dhe Taksave-Tarifave

Kryetar	Rolant Xhelilaj
Zv/Kryetar	Erzen Laçi
Sekretar	Hekuran Markola
Anëtar	Jonada Mamo
Anëtar	Alfred Mullaraj
Anëtar	Denisa Luana
Anëtar	Silvana Agasi
Anëtar	Dritan Burgija
Anëtar	Jonuz Myshketa
Anëtar	Xhojana Gjineci
Anëtar	Kontjana Kuçi

PRJ

Zv. Denis Lika Denis

KASTRUKUJI XHONGOLLI

PRJ